



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA  
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD  
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



**RAPORT 9 MUJOR**  
**MBI VLERESIMIN E PERFORMANCEN SË KRU- ve**  
**NË BAZË TË PËRMBUSHJES SË CAQEVE TË PËRCAKTUARA ME PROCESIN**  
**RREGULLATORË TË VITIT 2010**

Periodha e shikuar: 1 Janar – 30 Shtator 2010

Punuar nga:  
Departamenti për Financa dhe Tarifa Rregullatore (DFTRR/ZRRUM)

Prishtinë, Dhjetor 2010

### *Parathënie*

Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit, me të cilën vlerësohet përmbushja e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë për 9 mujorin e vitit (1 janar – 30 Shtator 2010) 2010 dhe jep një pasqyrë të sektorit për të njëjtat.

Raporti përmban të dhënat për çdo kompani veç e veç dhe pastaj pasqyron të dhënat e tërë sektorit

Raporti është përgatit mbi bazën e të dhënave të deklaruara të kompanive në Departamentin e Performancës (DP) në ZRRUM, sipas projektit të mbledhjes së të dhënave të Sistemit të Raportimit Financiarë, Operativë dhe të Shërbimeve për Konsumatorë (ROFK) dhe raportimit të dhënave të investimeve kapitale projekt për projekt në Departamentin e Financave dhe Tarifave Rregullatore (DFTRR).

I gjithë materiali i përgatitur është punuar në koordinim të ngushtë me të gjitha kompanitë.

## Përmbajtja

|                                                                                            |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT.....                                                  | 4  |
| 1.1. Paraqitja grafike e të dhënave për ujin e prodhuar dhe të faturuar sipas KRU-ve ..... | 6  |
| 2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE .....                                                   | 9  |
| 2.1. Mbulimi i shpenzimeve të përgjithshme operative nga shuma e arkëtimit .....           | 13 |
| 2.2. Paraqitja grafike e të dhënave për shpenzime operative sipas KRU-të .....             | 14 |
| 3. ANALIZA E FATURIMIT DHE ARKËTIMIT NË VLERË MONETARE .....                               | 15 |
| 3.1. Paraqitja grafike e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare për KRU-të .....        | 17 |
| 4. INVESTIMET KAPITALE .....                                                               | 19 |
| 4.1. Investimet e realizuara gjatë periudhës 9 mujore të vitit 2010 .....                  | 19 |
| 4.2. Paraqitja grafike e investimeve kapitale .....                                        | 23 |

## 1. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT

### Përshkrimi i gjetjeve

Nga analizat e bëra për të dhënat sasiore të prodhimit, humbjeve dhe faturimit të ujit dhe ujërave të zeza dhe numrit të konsumatorëve për nëntë (9) muorin e vitit 2010, dalin këto konkludime për çdo kompani veç e veç;

#### 1. KUR "Prishtina" sh. a. Prishtinë

Sasinë e ujit të prodhuar dhe ujit të humbur si dhe atë të faturimit të ujit dhe ujërave të zeza që të gjithë i ka negativë dhe që të gjithë në sasi të lartë me përjashtim të prodhimit të ujit ku dështimi është vetëm 1.00%.

Ndërsa e ka shumë pozitivë shtimin e numrit të konsumatorëve dhe atë për 23.00%.

#### 2. KUR "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë

Sasinë e ujit të prodhuar e ka pas pozitive për 6.00% dhe sasinë e ujërave të zeza të faturuar e ka pozitive për 16.00%, sikurse që e ka pozitive edhe shtimin e numrit të konsumatorëve.

Ndërsa sasinë e ujit të humbur si dhe faturimit të tij e kishte negativë.

#### 3. KUR "Hidrodrini" sh. a. Pejë

Sasinë e ujit të prodhuar dhe ujit të humbur për 9 muorin e vitit 2010 i kishte negativ, ndërsa të tre treguesit tjerë; faturimin e ujit të pastër, ujërave të zeza si dhe atë të shtimit të numrit të konsumatorëve i ka pozitivë

#### 4. KUR "Radoniqi" sh. a. Gjakovë

Të gjithë treguesit e vetë i ka negativë dhe e njëjta për këto të dhëna është shembull jo i mirë.

#### 5. KUR "Hidroregjioni-Jugor" sh. a. Prizren

Sasinë e ujit të prodhuar dhe numrin e konsumatorëve i ka pozitivë, ndërsa që të tre treguesit tjerë i ka negativë. Sasia e ujit të humbur duhet shikuar se duket të jetë e çrregulluar, pasi që mund të jenë bërë gabime ose te ne ose te kompania.

#### 6. KUR "Bifurkacioni" sh. a. Ferizaj

Edhe kjo kompani që të gjithë treguesit e vetë i ka negativë dhe e njëjta po ashtu nuk është shembull i mirë.

#### 7. KUR "Hidromorava" sh. a. Gjilan

Edhe kjo kompani që të gjithë treguesit e vetë i ka negativë dhe e njëjta po ashtu është shembull jo i mirë.

### Të dhënat sektoriale

Nga shikimi i këtyre të dhënave vetëm shtimi i numrit të konsumatorëve ishte trend pozitivë dhe prodhimi i ujit ishte në nivelet e planifikuara të prodhimit me procesin rregullatorë, ndërsa të tre treguesit tjerë si sasinë e ujit të humbur, faturimit të ujit dhe atë të ujërave të zeza i ka negativë dhe atë afër ¼ e gjithë sasive të planifikuara.

Kur krahasohen të dhënat 6 mujore me ato të kësaj periudhe 9 mujore të vitit 2010 nuk ka ndonjë tregues pozitivë, përveç sasisë së ujit të prodhuar, por pasi kemi humbje të ujit edhe ky tregues del të jetë negativë.

**Të dhënat për çdo kompani**

Në vijim po pasqyrojmë të dhënat e mbledhura të këtij grupimi në formë tabelore, me qëllim krahasimi më të lehtë të objektivave të përcaktuara me procesin rregullatorë për 9 muajt e parë të vitit 2010, për çdo kompani dhe për sektorin në formë të përmbledhur, pa komente të mëtejme.

*Tabela Nr. 1 Të dhënat sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe të ujërave të zeza të faturuara.*

| Emri i Kompanisë    | Të dhënat                  | Njësia         | Historike 2009 | Aprovuara 2010 | Realizuar a 2010 | %    | Vlerësimi përfundimtar 2010 |
|---------------------|----------------------------|----------------|----------------|----------------|------------------|------|-----------------------------|
| Prishtina           | Uji i prodhuar             | M <sup>3</sup> | 33,829,034     | 34,290,000     | 34,000,744       | -1   | Negativ                     |
|                     | Uji i humbur               |                | 18,160,559     | 14,258,925     | 18,389,763       | +29  | Negativ                     |
|                     | Uji i faturuar             |                | 15,668,476     | 20,031,075     | 15,610,981       | -22  | Negativ                     |
|                     | Ujërat e zeza të faturuara |                | 13,518,369     | 17,226,725     | 13,468,764       | -22  | Negativ                     |
|                     | Numri i konsumatorëve      | Nr             | 86,491         | 72,289         | 88,624           | +23  | Pozitiv                     |
| Mitrovica           | Uji i prodhuar             | M <sup>3</sup> | 13,018,945     | 12,435,000     | 13,161,226       | +6   | Pozitiv                     |
|                     | Uji i humbur               |                | 6,671,436      | 5,534,624      | 6,948,155        | +26  | Negativ                     |
|                     | Uji i faturuar             |                | 6,347,509      | 6,900,376      | 6,213,071        | -10  | Negativ                     |
|                     | Ujërat e zeza të faturuara |                | 3,890,980      | 3,295,788      | 3,808,571        | +16  | Pozitiv                     |
|                     | Numri i konsumatorëve      | Nr             | 21,314         | 20,080         | 21,388           | +7   | Pozitiv                     |
| Hidrodrini          | Uji i prodhuar             | M <sup>3</sup> | 21,144,344     | 22,500,000     | 21,799,768       | -3   | Negativ                     |
|                     | Uji i humbur               |                | 15,681,022     | 16,740,097     | 15,826,580       | -5   | Pozitiv                     |
|                     | Uji i faturuar             |                | 5,463,323      | 5,759,903      | 5,973,188        | +4   | Pozitiv                     |
|                     | Ujërat e zeza të faturuara |                | 3,531,182      | 2,995,150      | 3,860,730        | +29  | Pozitiv                     |
|                     | Numri i konsumatorëve      | Nr             | 30,896         | 30,065         | 32,433           | +8   | Pozitiv                     |
| Radoniqi            | Uji i prodhuar             | M <sup>3</sup> | 11,371,715     | 12,918,801     | 12,714,156       | -2   | Negativ                     |
|                     | Uji i humbur               |                | 6,274,677      | 6,185,675      | 7,949,253        | +29  | Negativ                     |
|                     | Uji i faturuar             |                | 5,097,038      | 6,733,127      | 4,764,903        | -29  | Negativ                     |
|                     | Ujërat e zeza të faturuara |                | 1,186,142      | 3,743,621      | 1,108,850        | -70  | Negativ                     |
|                     | Numri i konsumatorëve      | Nr             | 27,230         | 27,783         | 27,573           | -1   | Negativ                     |
| Hidroregjioni Jugor | Uji i prodhuar             | M <sup>3</sup> | 11,433,732     | 9,043,361      | 11,178,303       | +24  | Pozitiv                     |
|                     | Uji i humbur               |                | 6,315,664      | 3,107,185      | 6,326,145        | +104 | Negativ                     |
|                     | Uji i faturuar             |                | 5,118,068      | 5,936,177      | 4,852,158        | -18  | Negativ                     |
|                     | Ujërat e zeza të faturuara |                | 4,708,623      | 5,533,448      | 4,463,986        | -19  | Negativ                     |
|                     | Numri i konsumatorëve      | Nr             | 31,230         | 28,195         | 31,614           | +12  | Pozitiv                     |
| Bifurkacioni        | Uji i prodhuar             | M <sup>3</sup> | 3,816,480      | 4,902,344      | 4,406,647        | -10  | Negativ                     |
|                     | Uji i humbur               |                | 2,182,863      | 2,087,115      | 2,677,862        | +28  | Negativ                     |
|                     | Uji i faturuar             |                | 1,633,617      | 2,815,229      | 1,728,785        | -39  | Negativ                     |
|                     | Ujërat e zeza të faturuara |                | 1,378,508      | 2,401,852      | 1,458,815        | -39  | Negativ                     |
|                     | Numri i konsumatorëve      | Nr             | 13,694         | 18,750         | 15,002           | -20  | Negativ                     |
| Hidromorava         | Uji i prodhuar             | M <sup>3</sup> | 5,203,125      | 6,778,500      | 5,652,091        | -17  | Negativ                     |
|                     | Uji i humbur               |                | 2,965,739      | 2,711,034      | 3,399,276        | +25  | Negativ                     |
|                     | Uji i faturuar             |                | 2,237,386      | 4,067,466      | 2,252,815        | -45  | Negativ                     |
|                     | Ujërat e zeza të faturuara |                | 2,036,021      | 3,742,069      | 2,050,062        | -45  | Negativ                     |
|                     | Numri i konsumatorëve      | Nr             | 16,676         | 17,422         | 17,121           | -2   | Negativ                     |


**Tabela Nr. 2** Të dhënat sektoriale për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe të ujërave të zeza të faturuara.

| Të dhënat                  | Njësia         | Historike 2009 | Aprovuara 2010 | Realizuar a 2010 | %     | Vlerësimi përfundimtar |
|----------------------------|----------------|----------------|----------------|------------------|-------|------------------------|
| Uji i prodhuar             | m <sup>3</sup> | 99,817,376     | 102,868,007    | 102,912,935      | +0.04 | Pozitiv                |
| Uji i humbur               |                | 58,251,959     | 50,624,654     | 61,517,034       | +22   | Negativ                |
| Uji i faturuar             |                | 41,565,416     | 52,243,352     | 41,395,901       | -21   | Negativ                |
| Ujërat e zeza të faturuara |                | 30,249,826     | 38,938,651     | 30,219,777       | -22   | Negativ                |
| Numri i konsumatorëve      | Nr             | 227,531        | 214,584        | 233,755          | +9    | Pozitiv                |


### 1.1. Paraqitja grafike e të dhënave për ujin e prodhuar dhe të faturuar sipas KRU-ve

Në vijim do të paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e veçanta të çdo kompanie për prodhimin dhe humbjen e ujit si dhe të dhënave sasiore të ujit dhe ujërave të zeza të faturuara. Këto diagrame si të tilla nuk do të komentohen pasi që përmes tyre mund të vërehet qartë shkalla e realizueshmërisë së caqeve të caktuara nga ZRRUM, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtë kohore të vitit paraprak.


Diagrami Nr. 1 Prodhimi i ujit në m<sup>3</sup>




Diagrami Nr. 2 Uji i humbur në m<sup>3</sup>




Diagrami Nr. 3 Uji i faturuar në m<sup>3</sup>



Diagrami Nr. 4 Ujërat e zeza të faturuara në m<sup>3</sup>



Diagrami Nr. 5 Numri i Konsumatorëve





## 2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

### Përshkrimi i gjetjeve

Nga analizat e bëra për të dhënat e shpenzimeve për nëntë (9) mujorin e vitit 2010, dalin këto konkludime për çdo kompani veç e veç;

#### 1. KUR “Prishtina” sh. a. Prishtinë

Pagat e stafit te uji dhe kanalizimi si dhe shpenzimet tjera dhe totali i shpenzimeve të tjera që të gjithë i ka pozitivë, përveç shpenzimeve të energjisë elektrike të shërbimit të ujit të cilat kanë pësuar ngritje dhe vlerësohet negativisht nga këndë vështrimi i tyre.

Përgjithësisht kompania ka pas nën kontroll shpenzimet, por shpresojmë të mos ketë ndodhë në dëm të shërbimeve për konsumatorë.

#### 2. KUR “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë

Si trend pozitive te kjo kompani janë shpenzimet tjera operative te uji ku kemi pas zbritje të tyre prej 14.00% dhe të gjitha grupimet e shpenzimeve te shërbimi i kanalizimit , ndërsa me trende negative i ka shpenzimet e stafit, energjisë elektrike dhe totalin e shpenzimeve operative.

Kompania do të duhej të ketë pas kujdes në shpenzimet e veta operative.

#### 3. KUR “Hidrodrini” sh. a. Pejë

Si trende pozitive te kjo kompani janë shpenzimet tjera operative te uji ku kemi pas zbritje të tyre prej 51.00% dhe të gjitha shpenzimet e shërbimit te kanalizimi, ndërsa shpenzimet e stafit, energjisë dhe totalin e shpenzimeve operative i ka negative te shërbim i ujit, pasi që të njëjtat janë ngritë në krahasim me caqet e përcaktuara.

Edhe kjo kompani do të duhej të ketë pas kujdes në shpenzimet e veta operative.

#### 4. KUR “Radoniqi” sh. a. Gjakovë

Si trend pozitive te kjo kompani janë shpenzimet e pagave dhe ato të shpenzimeve të tjera operative te shërbimi i ujit dhe të gjitha grupimet e shpenzimeve te shërbimi i kanalizimit, ndërsa negative i ka shpenzimet tjera dhe totalin e shpenzimeve operative.

Edhe kjo kompani do të duhej të ketë pas kujdes në shpenzimet e veta operative.

#### 5. KUR “Hidroregjioni-Jugor” sh. a. Prizren

Shuma e shpenzimeve tjera operative te të dy shërbimet vlerësohet të kenë qenë pozitive pasi që kemi pas ulje të tyre në krahasim me shumat e lejuara dhe që të gjitha grupimet tjera të shpenzimeve i kemi negative. Trendi i uljes së shpenzimeve mund të ketë qenë i dëmshëm për shërbimet që kjo kompani u ofron konsumatorëve të vet.

Kompania do të duhej pas më shumë kujdes te grupimet tjera të shpenzimeve.

#### 6. KUR “Bifurkacioni” sh. a. Ferizaj

Shuma e shpenzimeve tjera operative te shërbimit të ujit ka pas ulje në krahasim me shumën e lejuar me procesin rregullatorë për periudhën kohore të shikuar, sikurse që kanë pas ulje edhe të gjitha grupimet tjera të shpenzimeve te shërbimet e kanalizimit.

Trende negative kanë qenë shpenzimet e pagave, energjisë elektrike dhe totali shpenzimeve dhe nga kjo del që shpenzimet tjera të vlerësuar si pozitive mund të ketë qenë në dëm të shërbimeve për konsumatorë.

Kompania do të duhej pas më shumë kujdes te grupimet tjera të shpenzimeve.

#### 7. KUR “Hidromorava” sh. a. Gjiilan,

Të gjithë treguesit i ka pozitiv pasi që ka pas ulje të shpenzimeve për këtë periudhë kohore në krahasim me objektivat e përcaktuara, përveç të shpenzimeve të energjisë elektrike të cilat vlerësohen si negative, pasi që ka pas ngritje të tyre lartë.

Ngritja e shpenzimeve të energjisë elektrike mund të ketë ndodhë nga lëshimi në punë i fabrikës së re për përpunim të ujit.

#### **Të dhënat sektoriale**

Nga shikimi i këtyre të dhënave mund të konkludohet se vetëm shpenzimet e energjisë elektrike kanë pas ngritje mbi objektivin e përcaktuar dhe që të gjitha grupimet tjera të shpenzimeve kanë dal të jenë nën caqe të përcaktuar apo lejuara dhe mund të vlerësohen si pozitive, nëse nuk janë bërë në dëm të konsumatorëve.

Si e dhënë pozitive kur shikohen të dhënat e dy periudhave 6 mujore dhe 9 mujore të këtij viti del të jetë fakti se shpenzimet në fund të këtij 9 mujorit të janë ulë në krahasim me shpenzimet e tilla në 6 mujorin e parë (55.00% - 44.00%) për 11.00%.

#### **Të dhënat për kompanitë veç e veç**

Të dhënat e mbledhura në këtë grupim do ti paraqesim në formë tabelore të thjeshtësuar, me qëllim krahasimi më të lehtë të caqeve të përcaktuara rregullatore dhe afarizmit 9-mujor të KRU-ve për vitin aktual dhe atë paraprakë.

Shënim: *Celulat e pa plotësuar në tabelën e mëposhtme nuk kanë mundur të vlerësohen, për mungesë të dhënave të kompanive përkatëse.*

*Kërkohet që të njëjtat të fillojnë ti mbajnë shënimet e tilla pa përjashtim*

Tabela Nr. 3 Analiza e shpenzimeve operative për periudhën 9 mujore të vitit 2010

| Emri i Kompanisë    | Të dhënat e shpenzimeve financiare | Njësia | UJË            |               |                |      |                       | KANALIZIM      |               |                |      |                       |
|---------------------|------------------------------------|--------|----------------|---------------|----------------|------|-----------------------|----------------|---------------|----------------|------|-----------------------|
|                     |                                    |        | Historike 2009 | Aprovuar 2010 | Realizuar 2010 | %    | Vlerës. përfund. 2010 | Historike 2009 | Aprovuar 2010 | Realizuar 2010 | %    | Vlerës. përfund. 2010 |
| Prishtina           | Stafi (personeli)                  | €      | 1,933,684      | 2,253,075     | 1,752,994      | -22  | Pozitiv               | 105,150        | 271,200       | 189,675        | -30  | Pozitiv               |
|                     | Energjia elektrike                 | €      | 1,375,460      | 1,124,700     | 1,653,259      | +47  | Negativ               | 5,780          | 29,775        | 13,531         | -55  | Pozitiv               |
|                     | Shpenzimet tjera operative         | €      | 1,305,114      | 1,724,475     | 894,078        | -48  | Pozitiv               | 10,380         | 73,875        | 20,333         | -72  | Pozitiv               |
|                     | Σ e shpenzimeve operative          | €      | 4,614,258      | 5,102,250     | 4,300,331      | -16  | Pozitiv               | 121,310        | 374,850       | 223,539        | -40  | Pozitiv               |
| Mitrovica           | Stafi (personeli)                  | €      | 618,892        | 638,250       | 671,251        | +5   | Negativ               | 38,529         | 75,750        | 68,899         | -9   | Pozitiv               |
|                     | Energjia elektrike                 | €      | 237,650        | 183,000       | 222,456        | +22  | Negativ               | 0              | 28,500        | 0              | -100 | Pozitiv               |
|                     | Shpenzimet tjera operative         | €      | 499,095        | 427,500       | 366,316        | -14  | Pozitiv               | 16,263         | 84,000        | 38,575         | -54  | Pozitiv               |
|                     | Σ e shpenzimeve operative          | €      | 1,355,636      | 1,248,750     | 1,260,023      | +1   | Negativ               | 54,792         | 188,250       | 107,474        | -43  | Pozitiv               |
| Hidrodrini          | Stafi (personeli)                  | €      | 592,812        | 443,325       | 667,815        | +51  | Negativ               | 31,201         | 75,150        | 35,296         | -53  | Pozitiv               |
|                     | Energjia elektrike                 | €      | 233,507        | 113,925       | 247,297        | +117 | Negativ               | 0              | 0             | 0              | !    | Pozitiv               |
|                     | Shpenzimet tjera operative         | €      | 246,703        | 393,600       | 191,791        | -51  | Pozitiv               | 11,826         | 35,100        | 22,958         | -1   | Pozitiv               |
|                     | Σ e shpenzimeve operative          | €      | 1,073,021      | 950,850       | 1,106,823      | +16  | Negativ               | 43,027         | 110,250       | 58,254         | -47  | Pozitiv               |
| Radoniqi            | Stafi (personeli)                  | €      | 899,216        | 941,025       | 921,211        | -2   | Pozitiv               | 64,018         | 71,100        | 65,007         | -9   | Pozitiv               |
|                     | Energjia elektrike                 | €      | 103,709        | 106,800       | 96,276         | -10  | Pozitiv               | 14             | 0             | 2,249          | !    | Negativ               |
|                     | Shpenzimet tjera operative         | €      | 338,179        | 293,175       | 338,062        | +15  | Negativ               | 7,597          | 11,850        | 9,475          | -20  | Pozitiv               |
|                     | Σ e shpenzimeve operative          | €      | 1,341,104      | 1,341,000     | 1,355,549      | +1   | Negativ               | 71,629         | 82,950        | 76,731         | -7   | Pozitiv               |
| Hidroregjioni Jugor | Stafi (personeli)                  | €      | 642,077        | 626,025       | 711,780        | +14  | Negativ               | 79,356         | 30,825        | 87,971         | +185 | Negativ               |
|                     | Energjia elektrike                 | €      | 348,824        | 286,350       | 313,549        | +9   | Negativ               | 46,557         | 21,150        | 38,753         | +83  | Negativ               |
|                     | Shpenzimet tjera operative         | €      | 425,964        | 287,850       | 256,259        | -11  | Pozitiv               | 14,402         | 39,375        | 21,558         | -45  | Pozitiv               |
|                     | Σ e shpenzimeve operative          | €      | 1,416,865      | 1,200,225     | 1,281,588      | +7   | Negativ               | 140,315        | 91,350        | 148,282        | +62  | Negativ               |
| Bifurkacioni        | Stafi (personeli)                  | €      | 259,073        | 169,050       | 279,692        | +65  | Negativ               | 29,185         | 91,200        | 53,304         | -42  | Pozitiv               |
|                     | Energjia elektrike                 | €      | 24,217         | 13,350        | 39,817         | +198 | Negativ               | 0              | 3,225         | 0              | !    | Pozitiv               |
|                     | Shpenzimet tjera operative         | €      | 110,714        | 146,250       | 67,530         | -54  | Pozitiv               | 4,166          | 102,825       | 6,106          | -94  | Pozitiv               |
|                     | Σ e shpenzimeve operative          | €      | 394,004        | 328,650       | 387,039        | +18  | Negativ               | 33,351         | 197,250       | 59,410         | -70  | Pozitiv               |
| Hidromorava         | Stafi (personeli)                  | €      | 246,506        | 335,850       | 347,609        | -4   | Pozitiv               | 19,167         | 83,925        | 35,962         | -57  | Pozitiv               |
|                     | Energjia elektrike                 | €      | 82,264         | 42,375        | 122,071        | +188 | Negativ               | 220            | 10,575        | 0              | !    | Pozitiv               |
|                     | Shpenzimet tjera operative         | €      | 445,019        | 358,950       | 183,259        | -49  | Pozitiv               | 8,405          | 89,775        | 10,666         | -88  | Pozitiv               |
|                     | Σ e shpenzimeve operative          | €      | 773,789        | 737,175       | 652,939        | -11  | Pozitiv               | 27,792         | 184,275       | 46,628         | -75  | Pozitiv               |

PS.: Vlerësimi përfundimtarë për zërin e caktuar të shpenzimeve të energjisë elektrike të ujërave të zeza, të kompanitë e "Radoniqi", "Hidromorava" dhe "Bifurkacioni" nuk janë mbajtur ose prezantuar si duhet. Kërkohej që kjo të tejkalohet të rastet tjera të prezantimit të dhënave të tilla.

Tabela Nr. 4 Të dhënat sektoriale të shpenzimeve operative

| Të dhënat e shpenzimeve<br>financiare | Njësia | UJË               |                  |                   |      |                             | KANALIZIM         |                  |                   |      |                                    |
|---------------------------------------|--------|-------------------|------------------|-------------------|------|-----------------------------|-------------------|------------------|-------------------|------|------------------------------------|
|                                       |        | Historike<br>2009 | Aprovuar<br>2010 | Realizuar<br>2010 | %    | Vlerës.<br>përfund.<br>2010 | Historike<br>2009 | Aprovuar<br>2010 | Realizuar<br>2010 | %    | Vlerësimi<br>Përfundimtar,<br>2010 |
| Stafi (personeli)                     | €      | 5,192,260         | 5,406,600        | 5,352,352         | -1%  | Pozitiv                     | 366,605           | 699,150          | 536,114           | -23% | Pozitiv                            |
| Energjia elektrike                    | €      | 2,405,629         | 1,870,500        | 2,694,725         | +44% | Negativ                     | 52,571            | 93,225           | 54,533            | -42% | Pozitiv                            |
| Shpenzimet tjera operative            | €      | 3,370,787         | 3,631,800        | 2,297,215         | -37% | Pozitiv                     | 73,040            | 436,800          | 129,671           | -70% | Pozitiv                            |
| Σ e shpenzimeve operative             | €      | 10,968,676        | 10,908,900       | 10,344,292        | -5%  | Pozitiv                     | 492,215           | 1,229,175        | 720,318           | -41% | Pozitiv                            |

Shumica e KRU-ve kanë rënie të lehtë të shpenzimeve operative, këtë e vërteton edhe tabela me të dhënat përmbledhëse të sektorit. Shpenzimet totale operative në sektorin e ujit janë ulur për 5.0%, ndërsa shpenzimet për shërbimet e kanalizimit 41% më të ulëta krahasuar me caqet e përcaktuara edhe pse numri i konsumatorëve është rritur për 9%.

Ulja e kostove të shërbimit, përkundër ngritjes së numrit të konsumatorëve të shërbyer mund të jetë një tregues i mirë dhe mund të komentohet në formë të ndryshme.

## 2.1. Mbulimi i shpenzimeve të përgjithshme operative nga shuma e arkëtimit


Tabela. Nr. 5 Të dhënat e mbulueshmërisë së shpenzimeve të përgjithshme operative të ndodhura gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2010, në këtë tabelë ka hy edhe shuma e investimeve vetanake

| NR | KRU                     | Arkëtimi<br>€ | Shpenzimet<br>Operative<br>€ | Mbetja<br>Financiare<br>€ | Investimet Kapitale<br>vetanake<br>€ | Shkalla e<br>Mbulueshmërisë |
|----|-------------------------|---------------|------------------------------|---------------------------|--------------------------------------|-----------------------------|
|    | A                       | B             | C                            | D                         | E                                    | F=B/(C+E)                   |
| 1  | Prishtina               | 5,252,576     | 4,523,870                    | 728,706                   | 330,348                              | 1.08                        |
| 2  | Mitrovica               | 794,223       | 1,367,497                    | -573,274                  | 28,284                               | 0.57                        |
| 3  | Hidrodrini              | 1,081,828     | 1,165,077                    | -83,249                   | 132,295                              | 0.83                        |
| 4  | Radoniqi                | 1,301,320     | 1,432,280                    | -130,960                  | 14,808                               | 0.90                        |
| 5  | Prizreni                | 1,323,532     | 1,429,870                    | -106,338                  | 203,004                              | 0.81                        |
| 6  | Bifurkacioni            | 464,990       | 446,449                      | 18,541                    | 23,982                               | 0.99                        |
| 7  | Hidromorava             | 643,413       | 699,567                      | -56,154                   | 22,500                               | 0.89                        |
|    | Të dhënat<br>sektoriale | 10,861,882    | 11,064,610                   | -202,728                  | 755,221                              | 0.92                        |


## 2.2. Paraqitja grafike e të dhënave për shpenzime operative sipas KRU-të

ZRRUM nuk do ti komentoj as të dhënat grafike të paraqitura më poshtë për shpenzimet operative për secilën KRU veç e veç, pasi që në të njëjtën mund të vërehen lëvizjet figurative të shpenzimeve të tilla, duke i krahasuar me shumat operative të shpenzimeve të aprovuara si dhe duke i krahasuar të njëjtat me periudhën e njëjtë kohore edhe të vitit 2009.

Diagrami Nr .6 Shpenzimet operative për ujë



Diagrami Nr. 7 Shpenzimet Operative për kanalizim



### 3. ANALIZA E FATURIMIT DHE ARKËTIMIT NË VLERË MONETARE

#### Përshkrimi i gjetjeve

Nga analizat e bëra për të dhënat monetare të faturimit dhe arkëtimit për nëntë (9) muorin e vitit 2010, dalin këto konkludime për çdo kompani veç e veç;

#### 1. KUR “Prishtina” sh. a. Prishtinë

Të dy treguesit ë shikuar kjo kompani i ka negativë dhe të pa përmbushur me objektivat e përcaktuar me procesin rregullatorë të kësaj periudhe të vitit 2010. Shkalla e arkëtimit është dukshëm më e ulët nga ajo e përcaktuar si cak e cila është për rreth 1/3 më e ulët se objektivi i përcaktuar.

#### 2. KUR “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë

Edhe kjo kompani që të dy treguesit i ka negativë dhe të pa përmbushur me objektivat e përcaktuar me procesin rregullatorë të kësaj periudhe të vitit Për të njëjtën duhet theksuar se shuma e arkëtimit për furnizim të pjesës veriore të qytetit nuk është e plotë dhe ky fakt mund të ketë ndikuar që tregues të jetë shumë negativë.

#### 3. KUR “Hidrodrini” sh. a. Pejë

Edhe kjo kompani që të dy treguesit e shikuar i ka negativë dhe të pa përmbushur me objektivat e përcaktuar me procesin rregullatorë të kësaj periudhe të vitit 2010. Me një dallim se shuma e faturimit është më pak negative se te dy kompanitë e para. Edhe në këtë rast shkalla e arkëtimit pak nën 1/3 e shumës së përcaktuar si cak.

#### 4. KUR “Radoniq” sh. a. Gjakovë

Trend edhe ma negativë ka edhe kjo kompani te të dy treguesit e shikuar dhe shkalla e mos përmbushjes së objektivave të faturimit është për 28.00% dhe ajo e arkëtimit për 37.00%, ose shkalla e arkëtimit është mbi 1/3 më e ulët se shuma e përcaktuar si cak.

#### 5. KUR “Hidroregjioni-Jugor” sh. a. Prizren

Edhe kjo kompani që të dy treguesit e shikuar i ka negativë dhe të pa përmbushur me objektivat e përcaktuar me procesin rregullatorë të kësaj periudhe të vitit 2010. Shuma e faturimit është më e ulët për 13.00%, ndërsa ajo e arkëtimit për 25.00%, ose shkalla e arkëtimit e shumës së përcaktuar si cak ma e ulët.

#### 6. KUR “Bifurkacioni” sh. a. Ferizaj

Edhe kjo kompani që të dy treguesit e shikuar i ka negativë dhe të pa përmbushur me objektivat e përcaktuar me procesin rregullatorë të kësaj periudhe të vitit 2010. Me një dallim se shuma e faturimit është më negative se te shumica e kompanive tjera dhe ka mbet pa u realizuar për 38.00%. Ndërsa shkalla e arkëtimit ka arrit të realizohet vetëm për 51.00% dhe afërsisht gjysma e faturimit të përcaktuar si cak ka mbet pa u inkasuar.

#### 7. KUR “Hidromorava” sh. a. Gjiilan

Kjo kompani që të dy treguesit e shikuar i ka shumë negativë dhe të pa përmbushur me objektivat e përcaktuar me procesin rregullatorë të kësaj periudhe të vitit 2010. Dallimi i vetëm është se shuma e faturimit është më negative se te të gjitha kompanitë tjera dhe ajo për faturim është 39.00% dhe e arkëtimit për 54.00% e pa përmbushur nga objektivat e caktuar të kësaj periudhe kohore.

#### Të dhënat sektoriale

Nga shikimi sektorial i këtyre të dhënave është evidente se që të dy treguesit edhe në këtë rast janë negativë , me një ndryshim se shkalla e arkëtimit është e pa përmbushur për më se 1/3 e shumës së përcaktuar si cak dhe ajo e faturimit për pak ma tepër se 1/5 e shumës së përcaktuar si cak.

Kur krahasohen të dhënat 6 mujore me ato të kësaj periudhe 9 mujore të vitit 2010 ka një ulje të treguesve gjatë këtij tre muorit të fundit të shikuar në krahasim me periudhën e 6 muorit të parë edhe pse nuk është shumë domethënëse duhet theksuar të njëjtën si fakt.

### Të dhënat për kompanitë veç e veç

Edhe në këtë rast të dhënat e mbledhura në këtë grupim do ti paraqesim në formë tabelore të thjeshtësuar, me qëllim krahasimi më të lehtë të caceve të përcaktuara rregullatore dhe afarizmit 9-muor të KRU-ve për vitin aktual dhe atë paraprakë.

Tabela Nr. 6 Të dhënat e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare për të dy shërbimet si dhe shumave nga tarifa fikse

| Emri i Kompanisë     | Të dhënat financiare | Njësia | Kategoritë e shpenzimeve dhe numri i konsumatorëve |                |                 |                 |                |                 | Σ e tarifës fikse | Σ e tarifës fikse | Σ e faturimit dhe arkëtimit për ujë dhe kanalizim |                 |
|----------------------|----------------------|--------|----------------------------------------------------|----------------|-----------------|-----------------|----------------|-----------------|-------------------|-------------------|---------------------------------------------------|-----------------|
|                      |                      |        | Ujë                                                |                |                 | Kanalizim       |                |                 |                   |                   |                                                   |                 |
|                      |                      |        | Realizuara 2009                                    | Aprovuara 2010 | Realizuara 2010 | Realizuara 2009 | Aprovuara 2010 | Realizuara 2010 | Aprovuar 2010     | Realizuar 2010    | Aprovuara 2010                                    | Realizuara 2010 |
| Pishtina             | Faturimi             | €      | 6,055,735                                          | 8,348,925      | 6,584,860       | 543,378         | 878,550        | 621,267         | 780,675           | 856,481           | 10,008,150                                        | 8,062,608       |
|                      | Arkëtimi             | €      | 4,843,462                                          | 6,392,010      | 4,289,862       |                 | 670,574        | 404,739         | 576,330           | 557,975           | 7,638,914                                         | 5,252,576       |
| Mitrovica            | Faturimi             | €      | 1,194,012                                          | 1,468,425      | 1,128,137       | 175,220         | 226,050        | 163,393         | 213,600           | 217,892           | 1,908,075                                         | 1,509,422       |
|                      | Arkëtimi             | €      | 811,709                                            | 1,117,657      | 586,126         |                 | 174,667        | 94,891          | 156,957           | 113,206           | 1,449,281                                         | 794,223         |
| Hidrodrini           | Faturimi             | €      | 1,270,724                                          | 1,414,800      | 1,389,006       | 151,649         | 205,950        | 165,239         | 377,775           | 335,864           | 1,998,525                                         | 1,890,109       |
|                      | Arkëtimi             | €      | 1,052,885                                          | 1,077,138      | 802,364         |                 | 157,037        | 85,451          | 279,487           | 194,013           | 1,513,662                                         | 1,081,828       |
| Radoniqi             | Faturimi             | €      | 1,444,944                                          | 2,272,050      | 1,510,944       | 160,361         | 181,950        | 164,548         | 314,625           | 308,632           | 2,768,625                                         | 1,984,124       |
|                      | Arkëtimi             | €      | 1,311,701                                          | 1,703,154      | 990,978         |                 | 136,571        | 107,921         | 235,574           | 202,421           | 2,075,299                                         | 1,301,320       |
| Hidroregjioni Jugor  | Faturimi             | €      | 1,470,547                                          | 1,770,375      | 1,511,248       | 214,627         | 269,475        | 204,898         | 328,275           | 333,916           | 2,368,125                                         | 2,050,062       |
|                      | Arkëtimi             | €      | 1,210,644                                          | 1,315,732      | 975,671         |                 | 199,994        | 132,283         | 243,133           | 215,578           | 1,758,859                                         | 1,323,532       |
| Bifurkacioni         | Faturimi             | €      | 486,365                                            | 673,950        | 547,309         | 77,912          | 394,200        | 103,767         | 216,375           | 145,083           | 1,284,525                                         | 796,159         |
|                      | Arkëtimi             | €      | 421,730                                            | 475,422        | 319,651         |                 | 278,906        | 60,604          | 159,286           | 84,735            | 913,614                                           | 464,990         |
| Hidromorava          | Faturimi             | €      | 707,423                                            | 1,226,775      | 735,822         | 132,833         | 297,900        | 142,131         | 196,650           | 174,272           | 1,721,325                                         | 1,052,225       |
|                      | Arkëtimi             | €      | 630,339                                            | 997,493        | 449,939         |                 | 241,704        | 86,910          | 160,560           | 106,564           | 1,399,757                                         | 643,413         |
| Shuma e përgjithshme | Faturimi             | €      | 12,629,749                                         | 17,175,300     | 13,407,326      | 1,455,979       | 2,454,075      | 1,565,243       | 2,427,975         | 2,372,140         | 22,057,350                                        | 17,344,709      |
|                      | Arkëtimi             | €      | 10,282,469                                         | 13,078,605     | 8,414,591       | 0               | 1,859,454      | 972,799         | 1,811,326         | 1,474,492         | 16,749,385                                        | 10,861,882      |

PS.: Celulat të cilat janë të zbrazëta, kanë mbetur si pasojë e mungesës së të dhënave nga KRU-të.



*Tabela Nr. 6.1. Vlerësimi përfundimtar i faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare*

| Emri i Kompanisë    | Të dhënat financiare | Njësia | Faturimi dhe arkëtimi për dy shërbimet |                 | %   | Vlerësimi përfundimtar |
|---------------------|----------------------|--------|----------------------------------------|-----------------|-----|------------------------|
|                     |                      |        | Aprovuara 2010                         | Realizuara 2010 |     |                        |
| Prishtina           | Faturimi             | €      | 10,008,150                             | 8,062,608       | -19 | Negativ                |
|                     | Arkëtimi             | €      | 7,638,914                              | 5,252,576       | -31 | Negativ                |
| Mitrovica           | Faturimi             | €      | 1,908,075                              | 1,509,422       | -21 | Negativ                |
|                     | Arkëtimi             | €      | 1,449,281                              | 794,223         | -45 | Negativ                |
| Hidrodrini          | Faturimi             | €      | 1,998,525                              | 1,890,109       | -5  | Negativ                |
|                     | Arkëtimi             | €      | 1,513,662                              | 1,081,828       | -29 | Negativ                |
| Radoniqi            | Faturimi             | €      | 2,768,625                              | 1,984,124       | -28 | Negativ                |
|                     | Arkëtimi             | €      | 2,075,299                              | 1,301,320       | -37 | Negativ                |
| Hidroregjioni Jugor | Faturimi             | €      | 2,368,125                              | 2,050,062       | -13 | Negativ                |
|                     | Arkëtimi             | €      | 1,758,859                              | 1,323,532       | -25 | Negativ                |
| Bifurkacioni        | Faturimi             | €      | 1,284,525                              | 796,159         | -38 | Negativ                |
|                     | Arkëtimi             | €      | 913,614                                | 464,990         | -49 | Negativ                |
| Hidromorava         | Faturimi             | €      | 1,721,325                              | 1,052,225       | -39 | Negativ                |
|                     | Arkëtimi             | €      | 1,399,757                              | 643,413         | -54 | Negativ                |


*Tabela Nr .6.2Të dhënat sektoriale për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare*

| Të dhënat financiare | Njësia | Faturimi dhe arkëtimi për dy shërbimet |                 | %   | Vlerësimi përfundimtar |
|----------------------|--------|----------------------------------------|-----------------|-----|------------------------|
|                      |        | Aprovuara 2010                         | Realizuara 2010 |     |                        |
| Faturimi             | €      | 22,057,350                             | 17,344,709      | -21 | Negativ                |
| Arkëtimi             | €      | 16,749,385                             | 10,861,882      | -35 | Negativ                |


### 3.1. Paraqitja grafike e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare për KRU-të

Në vijim do të paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare. Nga forma e tyre shihet shkalla e realizueshmërisë së objektivave të caktuara sipas marrëveshjes KRU-ZRRUM, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtë kohore të vitit paraprak.


Diagrami Nr. 8 Diagrami i faturimit të ujit në vlerë monetare



Diagrami Nr. 9 Diagrami i arkëtimit në vlerë monetare



Diagrami Nr. 10 Diagrami i ujërave të zeza të faturuara në vlerë monetare



## 4. INVESTIMET KAPITALE

Me procesin e rij rregullatorë të që të gjitha kompanive u janë lejuar shuma të caktuara të investimeve kapitale nga burimet e brendshme të financimit dhe natyrisht të gjitha projekteve kapitale të planifikuar për realizim nga donatorët potencial.

### Përshkrimi i gjetjeve

Nga analizat e bëra për të dhënat e mbledhura për realizim të projekteve investive financuar nga burimet e brendshme të kompanisë, mund të konkludohet se kompanitë në përgjithësi kanë dështuar ti përmbushin objektivat e përcaktuara për periudhën e shikuar kohore.

Ndërsa, investimet e realizuara nga donatorët e mundshëm tek 4 KRU kanë tejkaluar shumën e planifikuar për periudhën 9 mujore të vitit 2010.

### 4.1. Investimet e realizuara gjatë periudhës 9 mujore të vitit 2010

ZRRUM i ka kushtuar rëndësi të veçantë çështjes së realizimit të Investimeve Kapitale nga burimet vetanake të kompanisë, dhe për këtë, ka organizuar vizita sistematike duke u takuar me zyrtarë kompetent të KRU-ve, prej nga edhe kanë marrë të dhënat për investimet kapitale, të cilat janë të paraqitura në pasqyrat e më poshtme tabelore.

Tabela Nr.7 Investimet kapitale të planifikuara, të lejuara nga DFT/ZRRUM dhe të realizuara nga KRU-të për 9 muajt e parë të vitit 2010

| Emri Kompanisë                        | Kategoria e Investimeve | Investimet Kapitale të planifikuara për Ujë |             |            | Investimet kapitale të planifikuara për Kanalizim |             |            | Shuma e Investimeve të planifikuara nga kompania për 2009 € | Investimeve vetanake të lejuara me tarifen e vitit 2009 € | Investimet e realizuara gjatë vitit 2009 për Ujë |              | Investimet e realizuara gjatë vitit 2009 për Kanalizim |              |
|---------------------------------------|-------------------------|---------------------------------------------|-------------|------------|---------------------------------------------------|-------------|------------|-------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|--------------|--------------------------------------------------------|--------------|
|                                       |                         | Vetanake €                                  | Donacione € | Totali €   | Vetanake €                                        | Donacione € | Totali €   |                                                             |                                                           | Vetanake €                                       | Donacione €  | Vetanake €                                             | Donacione €  |
